



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/62
Datë: 23.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti nga mbledhja e 54 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e 55 elektronike\korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/62
Datë: 23.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Civile dhe Tregtare.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/62
Datë: 23.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/62
Datë: 23.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Shërbimin Korrektues të Kosovës.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/62
Datë: 23.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Shërbimin Sprovues të Kosovës.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/62
Datë: 23.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra. duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për 2 (dy) anëtarë të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Avni Sahiti, anëtar; dhe
 - 1.2. Znj. Fidane Spahija - Gjickolli, anëtare.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin bashkë me biografitë e kandidatëve të propozuar t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/62
Datë: 23.02.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në pajtim me nenin 19 dhe 50 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Punues ndërinstucional për rishikimin e Planit të Reagimit Kombëtar të Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Z. Xhelal Sveçla, Ministër i Punëve të Brendshme, kryesues,
 - 1.2. Zv. Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës - anëtar;
 - 1.3. Këshilltari për Siguri i Kryeministrit të Republikës së Kosovës - anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues i Zyrës për Planifikim Strategjik në Zyrën e Kryeministrit - anëtar;
 - 1.5. Përfaqësues i Zyrës Ligjore në Zyrën e Kryeministrit - anëtar;
 - 1.6. Përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes - anëtar;
 - 1.7. Përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme - anëtar;
 - 1.8. Përfaqësues nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - anëtar;
 - 1.9. Përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë - anëtar;
 - 1.10. Përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë - anëtar;
 - 1.11. Përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - anëtar;
 - 1.12. Përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - anëtar;
 - 1.13. Përfaqësues nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë - anëtar;
 - 1.14. Përfaqësues nga FSK-ja - anëtar;
 - 1.15. Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës - anëtar;
 - 1.16. Përfaqësues i Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave - anëtar.
2. Në këtë Grup punues të ftohen edhe përfaqësues nga Presidenca e Republikës së Kosovës si dhe nga Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes.
3. Në cilësinë e vëzhguesve dhe ekspertëve të ftohen përfaqësues nga Zyra për Bashkëpunim të Mbrojtjes e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfaqësues të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar dhe Përfaqësues të Ambasadës të Japonisë dhe Organizata Jo-Qeveritare.
4. Sipas nevojave të punës dhe për realizimin e obligimeve të parapara me këtë vendim Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftojë ekspertë dhe përfaqësues të tjerë vendor dhe ndërkombëtar.

5. Përgjegjës për mbështetjen administrative dhe koordinimin e rishikimit të Planit të Reagimit Kombëtar të Republikës së Kosovës është Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës.
6. Afati e rishikimit të Planit të Reagimit Kombëtar Republikës së Kosovës është 6 (gjashtë) muaj nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/62
Datë: 23.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete buxhetore në shumë prej 10,000,000.00 € (dhjetë milion euro) për zbatimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, dhe Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike për zbatimin e Masës 3.8- Rritja e rezervave shtetërore.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Programi i Ringjalljes Ekonomike, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas pikës 2. të këtij Vendimi transferohen në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e me kod 204, në nën-programin Departamenti i Rezervave me kod 24000, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098).
4. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/62
Datë: 23.02.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 3,500,000 € (tre milion e pesëqind mijë euro) për Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, me kod 201, për zbatimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, dhe Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021 (këtëj e tutje referuar si "Vendimi i Pakos së Ringjalljes Ekonomike) lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike për Masat 1.1, 1.2, 1.3, 1.5 dhe 3.1.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Programi i Ringjalljes Ekonomike, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" dhe ndahen në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, me kod 201, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", në nën-programet, si në vijim:
 - 2.1. Shërbimet e Punësimit me kod 43100, shuma prej 1,000,000 € (një milion euro), për zbatimin e Masave 1.1- Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë, Masa 1.2- Mbështetja për të punësuarit e formalizuar, dhe Masa 1.3- Mbështetja e punësimit të grave;
 - 2.2. Shërbimet e Punësimit me kod 43100, shuma prej 500,000 € (pesëqind mijë euro), për zbatimin e Masës 1.5 - Trajnimi dhe punësimi në TI;
 - 2.3. Ndhimat sociale, me kod 00500, shuma prej 2,000,000 € (dy milion euro), për zbatimin e Masës 3.1. Mbështetje për familjet që kanë humbur kryefamiljarin.
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës, pas përfundimit të procesit dhe aprovimit të listës së përfituesve, sipas kriterëve dhe kushteve të dala nga vendimet për zbatimin e masave 1.1, 1.2, 1.3, 1.5 dhe 3.1 të marra sipas autorizimeve të Vendimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/62

Datë: 23.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 100,000.00 € (njëqind mijë euro) për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për zbatimin e Vendimit të Qeverisë Nr.13/19 të datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.12/31 të datës 25.08.2021, dhe Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021 (këtëj e tutje referuar si " Vendimi i Pakos së Ringjalljes Ekonomike) lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike për Masën 4.3 – Mbështetja e Kulturës dhe Sportit.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Programi i Ringjalljes Ekonomike, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas pikës 2. të këtij Vendimi transferohen në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me kod 207, në nën-programin "Përkrahja e Kulturës" me kod 80500 në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" shuma prej 75,000.00 € (shtatëdhjetë e pesë mijë euro) dhe në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" shuma prej 25,000.00 € (njëzetë e pesë mijë euro).
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/62
Datë: 23.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29, paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21, të nenit 14, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve që të aprovojë transferet nga nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" në nën-program tjetër në tabelën 3.1 dhe 4.1 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, për shumat individuale të kërkuara deri në vlerë prej 40,000 € (dyzet mijë euro).
2. Shuma e përgjithshme e autorizimit sipas pikës 1. të këtij Vendimi nuk mund të kalojë 20% (njëzetë për qind) të shumës së ndarë vjetore të nën-programit "Shpenzimet e Paparashikuara".
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/62
Datë: 23.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

Për ndarjen e mjeteve për mbështetjen e autorëve të teksteve shkollore për lëndët nacionale të komunitetit Boshnjak dhe Turk


1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për ndarjen e mjeteve për mbështetjen e autorëve të teksteve shkollore për lëndët nacionale të komunitetit Boshnjak dhe Turk në vlerë prej 78,000.00 € (shtatëdhjetë e tetë mijë euro) në kuadër të detyrimit ligjor për të siguruar tekstet shkollore për nxënësit e klasës I-IX.
2. Buxheti i cili do të merret për mbulimin e obligimeve nga kodi i projektit "blerja e librave" i cili është i buxhetuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në nën-programin "Investimet kapitale në arsimin parauniversitar" me kod 98100, shuma prej 4,716,885 € (katër milionë e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë e pesë euro) në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime për blerjen e librave nga klasa 1 deri 9.
3. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij Vendimi, ndahen prej buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për këtë qëllim.
4. Mjetet financiare barten në xhirollogarinë bankare të autorëve të teksteve për klasën I-IX për lëndët nacionale.
5. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë dhe Inovacionit, për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë si dhe nevojën për ndarjen e mjeteve për mbështetjen e autorëve të teksteve shkollore për lëndët nacionale të komunitetit Boshnjak dhe Turk në kuadër të detyrimit ligjor për të siguruar tekstet shkollore për nxënësit e klasës I-IX, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/62
Datë: 23.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme private e cila preket nga ndërtimi i "Shiritit për Rreshtim" për hyrje në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, Rruga Nacionale N2 Prishtinë-Mitrovicë, Zona Kadastrale: Prishtinë, Komuna Prishtinë, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabela e bashkëngjitur këtij Vendimi në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe 1 (një) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij Vendimi.
8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcellave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/62
Datë: 23.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 25, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

Për zgjatjen masave emergjente në furnizimin e energjisë

1. Qeveria Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës, zgjatjen e masave emergjente në furnizimin e energjisë, me qëllim të normalizimit të plotë të gjendjes në nivel të shtrirjes dhe kohëzgjatjes së nevojshme prej tridhjetë (30) ditësh.
2. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/51 të datës 24.12.2021.
3. Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/62
Datë: 23.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 13/19 i datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, dhe me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, ashtu që i shtohet Masa 3.8 me tekstin në vijim:
 - Masa 3.8- Rritja e rezervave shtetërore 10,000,000.00 € (dhjetë milion euro).
2. Masa 3.8- Rritja e rezervave shtetërore, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, do të shfrytëzohet për rritjen e sasisë së rezervave shtetërore me qëllim të reagimit të shpejtë në situata të jashtëzakonshme.
3. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, dhe me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021 mbesin të pandryshuara.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë